



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tel. 042 251267

Nr. 928 Prot.

Tiranë, më 11/11 /2013

Lënda: Kërkesë për auditimin e veprimtarisë ekonomike dhe administrative të KLSH-së për periudhën 2002-2012.

Drejtuar: **Z. Erion BRAÇE**
Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat

TIRANË

Paraprakisht, më lejoni t'Ju falenderoj për ndihmën dhe mbështetjen morale që Kuvendi i Shqipërisë dhe veçanërisht Komisioni i Ekonomisë dhe Financave që Ju drejtoni, i ka dhënë gjatë vitit 2012 e vijim institucionit të KLSH, për përmbushjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të programuara nga KLSH për këtë vit, njëkohësisht për plotësimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të 26 prillit 2012 "Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH për vitin 2011".

Duke marrë shkas se edhe gjatë vitit 2012 e 2013 nuk u ushtrua auditim mbi llogaritë e KLSH-së dhe bërjen publike të tyre, dhe njëherësh duke ju referuar faktit se kanë kaluar mbi 11 vjet që nuk auditohen këto llogari, më duhet t'Ju drejtohem përsëri, duke parashtruar përsa vijon:

- Në nenin 3, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, përcaktohet:

"KLSH duhet çdo vit të përgatisë llogaritë e tij në përputhje me ligjin për buxhetin. Llogaritë e tij kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe raporton te ky".

Për këtë, u jam drejtuar drejtuesve të mëparshëm të Kuvendit me shkresën nr. 208/1, datë 3/2/2012 dhe nr. 195, datë 14.02.2013 duke kërkuar kontrollin e veprimtarisë ekonomike dhe administrative të KLSH-së për periudhën 2002-2012.

Kryerja e auditimit të jashtëm të pavarur në institucionet supreme të auditimit (SAI) cilësohet dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI (ISSAI 20, Parimi 6), po kështu dhe në rekomandimet e paraqitura nga SIGMA në raportet e vlerësimit të veprimtarisë të KLSH-së për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012.

Ne si KLSH i kemi kërkuar Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), duke patur parasysh historinë tashmë 16 vjeçare të IEKA-s dhe profesionalizmin e treguar ndër vite prej saj, me shkresën Nr. 926 dt. 12.11.2013, që të auditojë fondet tona për dy vitet 2012-2013 që unë drejtoj KLSH. Këtë e kemi bërë dhe në respekt të kërkesave të standardeve ndërkombëtare të fushës, INTOSAI, që ne duam t'i zhvillojmë, si dhe për faktin që IEKA shumë vite më parë e ka audituar KLSH-në.

Përsa më sipër, e kërkoj sërish zyrtarisht auditimin e llogarive të KLSH-së për periudhën 2002-2012 dhe bërjen publike të tyre, duke plotësuar një detyrim të përmbajtur në ligjin tonë integral dhe në standardet ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

Bujar LESKAJ

KRYETAR

